

FJALA E DEPUTETIT LULZIM BASHA

E ENJTE 12 MAJ 2022

Zonja dhe zotërinj,

Të dashur bashkëqytetarë,

Të dashur bashkëkombës,

14 vjet pas shpalljes së Kosovës së pavarur, rajoni ynë ka përjetuar një çlirim nga makthet e destabilizimit dhe të luftës. Investimi në Kosovën e pavarur, në Kosovën e të drejtave të barabarta të çdo qytetari të saj, në Kosovën krah për krah me bijtë dhe bijat me uniformën e vendeve anëtare të NATO-s, është investimi më i suksesshëm global, në veçanti i demokracive Perëndimore. Sot kemi rastin të përshëndesim njëzëri një moment kyç të zhvillimeve për Ballkanin dhe për kombin shqiptar: aplikimin e Kosovës si anëtare me të drejta të plota në Këshillin e Europës.

Personalisht, ndiej një kënaqësi të dyfishtë teksa shikoj një hap të menduar e të planifikuar për vite me radhë, në bashkëpunim ndërmjet qeverisë së Tiranës dhe Prishtinës, i cili tani të jetësohet me mbështetjen totale dhe të rakorduar të anëtarëve të Këshillit të Europës. Nuk ka si të jetë ndryshe, progresi i Kosovës është domethënës dhe do të thosha më shumë se kaq. Kjo dekadë ka shënuar në të gjitha kryeqytetet e Ballkanit Perëndimor rrëshqitje në indekset e demokracisë, por jo në Kosovë, e cila në çdo rast kur është përballur me sprovat elektorale, në çdo rast kur është përballur me përpjekjen për ta mbajtur të ngrirë konfliktin, në çdo rast kur është përballur me zgjedhjen mes dhunës, kaosit, diktatit të krimit të organizuar me mbështetje politike, ka provuar se ka qenë në anën e duhur, atë të shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë pakicat kombëtare në Republikën e Kosovës. Ajo ka respektuar de facto dhe de jure të gjitha kërkesat, standardet dhe parimet e Këshillit të Europës.

Ndaj, thirrja ime e parë dhe kryesore u drejtohet sot të gjitha instancave të shtetit shqiptar që ta konsiderojnë me seriozitet maksimal këtë moment dhe t'i japin të gjithë mbështetjen e nevojshme, duke nisur nga parlamenti dhe delegacioni ynë në asamblenë parlamentare. Së dyti, ta konsiderojmë jo një hap të izoluar, por pjesë të përpjekjes kombëtare përfshirjen e Kosovës në të gjithë zinxhirin e organizatave, që përfaqësojnë identitetin tonë kombëtar dhe vlerat tona properëndimore, në veçanti

për shtyrjen përpara të përgatitjes së Forcave të Armatosura, të Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe përgatitjen e procesit dhe dialogut politik për partneritetin për paqe dhe anëtarësimin e Kosovës në NATO.

Si përfundim, dua t'i uroj qytetarët e Kosovës, popullin e Kosovës, autoritetet e Kosovës dhe të gjitha forcat politike në Kosovë dhe iu siguroj për mbështetjen time të plotë personale dhe jam i sigurt të të gjithë atyre, të cilët e konsiderojnë këtë ditë të veçantë dhe një ogur të mirë për zhvillimet që do të vijjnë; dua t'i përgëzoj dhe t'i kërkoj një bashkëpunim sa më të frytshëm për realizimin e këtij shteti dhe këtij objekti madhor që nis sot me aplikimin e Kosovës. Shpresojmë që së shpejti, përkundër hijeve të zeza, që edhe sot nuk munguan aty, ku ende ndërgjegjja është e paqetësuar nga plagët dhe nga krimet e gjenocidit të dekadës së viteve '90 dhe përkundër skepticizmit, të ecim përpara të vendosur për një Kosovë anëtare të Këshillit të Europës, për një Kosovë në institucionet euroatlantike. Faleminderit!